

Prill 2025 | Nr. 48

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI NJË VIZITË PUNE NË LONDËR





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI NJË VIZITË PUNE NË LONDËR

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z.Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në Londër në institucionet e drejtësisë, që merren me inspektimin dhe procesin disiplinor të magjistratëve dhe në Ministrinë e Jashtme britanike. Z.Metani u shoqërua nga një ekip i ILD-së dhe nga ambasadori i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar z. Uran Ferizi.

Në Inspektoratin e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës së Madhërisë së Tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u mikprit nga Kryeinspektori z. Anthony Rogers.

Të dy bashkëbiseduesit u ndalën në ndarjen e praktikave të mira mes institucioneve dhe rolin që ka procesi i inspektimeve në efikasitetin e sistemit të drejtësisë për promovimin e transparencës e paanësisë, në shërbim të besimit të publikut.

Më tej z. Metani dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilluan sesione pune me ekipin e Inspektoratit britanik të Prokurorisë. Zëvendës Kryeinspektoria znj.Lisa Morris bëri prezantimin e Inspektoratit të Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës.



Procesi i inspektimeve, inspektimet te- Rekomandimet dhe impakti i inspektimeve u matike dhe inspektimet pasuese u paraqitën trajtua nga z.Rogers dhe znj.Morris, duke iu nga Inspektori i Lartë ligjor z. Colin Darroch përgjigjur interesit të ekipit të ILD-së për dhe nga Inspektorja ligjore znj. Leanne aspekte të punës dhe krahasim me modelin e Shqipërisë.





Më tej z. Metani dhe delegacioni që e znj. Kim Webb me të gjitha aspektet e shoqëronte zhvilluan sesione pune me punës mbi hetimin e sjelljeve të gjyqtarëve ekipin e Inspektoratit britanik të britanikë për llogari të Ministrit të Prokurorisë. Zëvendës Kryeinspektorja Drejtësisë dhe Drejtueses së gjyqësorit në znj. Lisa Morris bëri prezantimin e Mbretërinë e Bashkuar.

Inspektoratin e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës. Procesi i inspektimeve, inspektimet tematike dhe inspektimet pasuese u paraqitën nga Inspektori i Lartë ligjor z. Colin Darroch dhe nga Inspektorja ligjore znj. Leanne Townsend.

Rekomandimet dhe impakti i inspektimeve u trajtua nga z. Rogers dhe znj. Morris, duke iu përgjigjur interesit të ekipit të ILD-së për aspekte të punës dhe krahasim me modelin e Shqipërisë.

Në takimin e zhvilluar në Zyrën e Hetimeve të Sjelljes Gjyqësore ekipi i ILD-së u njoh nga drejtuesi operativ z. Simon Parsons dhe shefja e çështjeve pranë kësaj zyre,

Ngjashmëritë në procesin e hetimit disiplinor, llojet e shkeljeve disiplinore dhe masat ndëshkuese ndaj gjyqtarëve u trajtuan gjerësisht gjatë takimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani dhe z. Parson e znj. Webb nga Zyra e Hetimeve të Sjelljes Gjyqësore.

Pjesë e vizitës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Londër ishte edhe një takim në Ministrinë e Jashtme britanike, me drejtoreshën për Ballkanin Perëndinor znj. Madeline Knox.

Pasi i bëri një prezantim të funksioneve e rolit të ILD-së në sistemin e drejtësisë,

Ngjashmëritë në procesin e hetimit disiplinor, llojet e shkeljeve disiplinore dhe masat ndëshkuese ndaj gjyqtarëve u trajtuan gjerësisht gjatë takimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani dhe z.Parson e znj. Webb nga Zyra e Hetimeve të Sjelljes Gjyqësore.

z.Metani vlerësoi mbështetjen e publikut tek sistemi i drejtësisë. vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar për shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Shqipërisë.

Znj.Knox vërejti se marrëdhënia me Shqipërinë është shumë e rëndësishme për Mbretërinë e Bashkuar, që ka investuar për këtë sepse e konsideron një partneritet të rëndësishëm edhe për të ardhmen.

Z. Metani dhe znj.Knox bashkëndanë qëndrimin e përparimit të Shqipërisë në fusha prioritare siç është lufta kundër korrupsionit, shteti i së drejtës dhe besimi i

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe delegacioni i ILD-së u mikpritën në ambasadën e Shqipërisë në Lodër nga ambasadori z. Uran Ferizi. Pasi falenderoi ambasadorin për mbështetjen në organizimin e kësaj vizite, z.Metani u informua nga z.Ferizi mbi punën e Ambasadës sonë në mbrojtje të interesave të Shqipërisë e shqiptarëve që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe kontributin britanik për përparimin e vendit tonë.



FOTO NGA VIZITA PUNËS E ILD-SË NË LONDËR





KLGI PRANON KËRKESËN E ILD PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ GJYQTARES A.XH.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pranoi kërkesën e lemnitetit, rregullave të sjelljes në Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pro- marrëdhëniet me magjistratët e tjerë. Heti- cedim disiplinor me masën “Vërejtje pub- mi disiplinor i ILD ka filluar mbi bazën e like” ndaj magjistrates A.Xh., me detyrë shqyrtimit të informacionit të pasqyruar në gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së parë procesverbalin e një mbledhje të përgjith- të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shme të gjyqtarëve të shtatorit 2024, gjatë shkeljen disiplinore të parashikuar si shkelje të cilës janë zhvilluar debate mbi disa pro- e përsëritur ose e rëndë e rregullave të so- cese pune në gjykatë.

Hetimi disiplinor i ILD ka filluar mbi bazën e shqyrtimit të informacionit të pasqyruar në procesverbalin e një mbledhje të përgjithshme të gjyqtarëve të shtatorit 2024, gjatë së cilës janë zhvilluar debate mbi disa procese pune në gjykatë.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konstatuar se magjistratja A. Xh., në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues ka shkelur rregullat e sjelljes me magjistratët e tjerë, pjesë e trupit gjykues, gjatë zhvillimit të një seance publike.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konstatuar se magjistratja A. Xh., në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues ka shkelur rregullat e sjelljes me magjistratët e tjerë, pjesë e trupit gjykues, gjatë zhvillimit të një seance publike.

Kjo sjellje e magjistrates ka qënë e vazhdueshme gjatë gjithë seancës, duke cënuar besimin e palëve të pranishme në seancë tek drejtësia, diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit dhe cënuar integritetin dhe reputacionin e gjykatës.

Në raportin hetimor vërehet se shkelja disiplinore nga ana e magjistrates është kryer me dashje direkte, vërtetuar kjo edhe nga deklaratimet e dhëna nga vetë magjistratja gjatë hetimit disiplinor.

Në raport evidentohet si rrethanë lehtësuese, fakti se magjistratja e ka pranuar që sjellja e

saj në praninë e palëve, në atë seancë publike nuk ka qënë në përputhje me etikën dhe se ajo nuk duhet të kishte atë sjellje në prezencë të palëve.

Nga ana tjetër, magjistratja nuk ka masë të mëparshme disiplinore dhe ka eksperiencë të pakët profesionale, pasi shkelja është kryer në vitin e parë të punës si gjyqtare.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludon se sjellja dhe veprimet e magjistrates A. Xh., në rastin konkret vlerësohen si “Shkelje e lehtë disiplinore” dhe i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” për gjyqtaren A.Xh., të parashikuar nga neni 105 pika 1 shkronja “b” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkesë që u pranua në mënyrë unanime nga anëtarët e KLJG-së.

Në raportin hetimor vërehet se shkelja disiplinore nga ana e magjistrates është kryer me dashje direkte, vërtetuar kjo edhe nga deklaratimet e dhëna nga vetë magjistratja gjatë hetimit disiplinor.



KL Gj PRANON PJESËRISHT KËRKESËN E ILD PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË GJYQTARES A.LL.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pranoi pjesërisht kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj magjistrates A. Ll., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke caktuar masën “Pezullim nga detyra për 6 muaj”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kishte propozuar Keshillit të Lartë Gjyqësor masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”, për magjistraten A. Ll., për veprime/mosveprime që përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të afateve procedurale civile dhe penale të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe mosvënie në

lëvizje të çështjeve civile, duke tejkaluar afatet tej çdo logjike, e në mënyrë të vazhdueshme.

Hetimi disiplinor i ILD ndaj magjistrates ka nisur bazuar në 11 ankesa të paraqitura me pretendime për mos përmbushje të rregullt të detyrës, e shkelje të afateve procedurale civile e penale. Gjatë këtij hetimi, inspektorët e ILD kanë evidentuar edhe fakte të tjera, të cilat i janë shtuar hetimit të nisur.

Në shumë raste nga regjistrimi i çështjeve dhe caktimi i tyre gjyqtare, janë evidentuar mos kryerje veprimesh për një periudhë

Në raportin e hetimit nënvizohet se respektimi i afateve të gjykimit dhe të arsyetimit kanë rëndësi themelore për garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe në veçanti të afatit të arsyeshëm.

prej rreth mbi 3 vite. Rreth 64% e çështjeve civile të themelit për vitin 2021 dhe 90% për vitet 2022 dhe 2023 janë në tejkalim të afatit ligjor të arsyetimit/dorëzimit (vendime të llojit kryesisht vërtetim fakti juridik për njohje vërtetësie e zgjidhje martesë, njohje pronësie apo pjesëtim pasurie.) Vendimet e pa dorëzuara në vitin 2023, janë 43% e vendimeve tej afatit ligjor.

Në raportin e hetimit nënvizohet se respektimi i afateve të gjykimit dhe të arsyetimit kanë rëndësi themelore për garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe në veçanti të afatit të arsyeshëm. Vonesa të tilla dëmtojnë të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt gjyqësor, duke u cenuar të drejtën për të pasur një vendim të arsyetuar dhe për të bërë ankim, duke dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të.

Veprimet e gjyqtarës janë kryer të paktën

me pakujdesi në formë neglizhencës, e përsëritur dhe e vazhdueshme, e në disa raste kanë shkaktuar dëm në procedurat hetimore. Gjyqtarja ka dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, edhe pse ka 24 vite eksperiencë, tregues i njohjes shumë të mirë të ushtrimit të detyrës me disiplinë.

Nga hetimi bazuar në materialet voluminoze të administruara e shqyrtuara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë arriti në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga gjyqtarja përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”, parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” dhe “dh” të ligjit “Për statusin” dhe i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për gjyqtaren A. Ll., kërkesë që u pranua pjesërisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, që caktoi një masë tjetër për gjyqtaren, atë të pezullimit për 6 muaj nga detyra.

Veprimet e gjyqtarës janë kryer të paktën me pakujdesi në formë neglizhencës, e përsëritur dhe e vazhdueshme, e në disa raste kanë shkaktuar dëm në procedurat hetimore. Gjyqtarja ka dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, edhe pse ka 24 vite eksperiencë, tregues i njohjes shumë të mirë të ushtrimit të detyrës me disiplinë.



KLP PRANON PJESËRISHT KËRKESËN E ILD PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATIT K. LL.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur veprime e sjellje, që përbëjnë shkelje pranimin pjesërisht të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj magjistratit K.Ll., duke caktuar masën “Ulje page në masën 20% për 3 muaj”, përkundër propozimit të ILD për “Ulje page në masën 40% për 1 vit”, ndërsa ka pranuar plotësisht propozimin e ILD për masën “Largimi nga detyra e kryetarit”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nisi hetimin disiplinor ndaj magjistratit Ll., në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, bazuar në 6 ankesa të një prokuroreje në të njëjtin institucion, për

Hetimi disiplinor i kryer nga ILD konkludoi se veprimet e mosveprimet e z. Ll. përbëjnë mos përmbushje, në cilësinë e drejtuesit, të detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti e detyrave që lidhen me sistemin e menaxhimit të çështjeve.

Nga hetimi u konstatuan shkelje të përsëritura të rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me magjistratët e tjerë. Shkelja disiplinore vërehet në raport, është kryer me dashje direkte dhe ekziston rreziku që ndikimi negativ i saj të shtrihet në zyrën e prokurorisë në tërësi, duke përbërë

rrezik për përsëritje ngjarjesh, që ulin imazhin e zyrës së prokurorisë.

Magjistrati ka marrë masën disiplinore “Vërejtje Publike” për një shkelje të mëparshme nga ana e KLP-së, me datë 30.01.2025, për veprime dhe mosveprime, që përbëjnë mos përmbushje të pajustificuar të funksioneve gjatë hetimit, duke sjellë zvarritje të pajustificuar të akteve procedurale, e duke mos përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat, duke lënë pa veprime dosjen hetimore për një periudhë mbi 2 vjeçare.

Gjatë parashtrimeve para KLP-së inspektorja e ILD-së vërejtë, se në kohën e depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, prokurori K.L., ushtronte të njëjtën detyrë, si në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar.

Aktualisht ai nuk ushtron detyrën as si Drejtues as si prokuror, për shkak se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka caktuar masën e sigurimit personal “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” ndaj këtij magjistrati, si i

dyshuar për veprën penale të “Korrupsionit pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal.

Në konkludim, ILD i propozoi KLP-së caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një periudhë 1 vjeçare” ndaj magjistratit K. Ll, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “l”, si dhe neni 102 pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe një masë të disiplinore plotësuese “Largimi nga detyra e kryetarit”, të parashikuar nga neni nga neni 108 dhe neni 112, pika 2, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kërkesa e parë u pranua pjesërisht nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që caktoi masën “Ulje 20% e pagës për një periudhë 3 mujore” dhe pranoi plotësisht kërkesën e ILD për masën plotësuese “Largim nga detyra e kryetarit” për magjistratin K.Ll.

ILD i propozoi KLP-së caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një periudhë 1 vjeçare” ndaj magjistratit K. Ll, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “l”, si dhe neni 102 pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe një masë të disiplinore plotësuese “Largimi nga detyra e kryetarit”.



KLGI PRANON KËRKESËN E ILD PËR PROCEDIM DISIPLINOR PËR MAGJISTRATIN B.SH.

Në seancën e sotme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Vërejtje publike” ndaj gjyqtarit B.SH., zëvendëskryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ky hetim disiplinor i përket vitit 2021 dhe ishte pezulluar nga KLGI në vitin 2022 për shkak të procesit të rivlerësimit, të cilit po i nënshtrohej magjistrati B.SH.

Hetimi ndaj gjyqtarit ka nisur bazuar në ankesa në vazhdimësi pranë ILD-së nga kancelarja, me pretendimet se magjistrati në pozicionin e zv.kryetarit të Gjykatës Ad-

ministrative të Shkallës së Parë Vlorë, e pengonte në ushtrimin e detyrave ligjore, duke mos lejuar funksionimin normal të gjykatës.

Hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludoi se B.SH. ka lejuar moszbatimin, pa shkaqe të justifikuara, të vendimit të dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor lidhur me kancelaren e gjykatës, si dhe në mënyrë të përsëritur, gjatë dy mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës, nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave.

Ndërmarrja e këtyre veprimeve nga

Në përfundim të hetimit, ILD duke mbajtur në konsideratë mes të tjerash, natyrën e shkeljes disiplinore, ekzistencën e rrethanës lehtësuese, e lidhur me shkeljet për herë të parë, bashkëpunimin e magjistratit gjatë hetimit, si dhe ndihmën në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e shkeljes, arriti në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e zvkryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, B.SH., përbëjnë shkelje disiplinore.

magjistratit vërehet në raportin e ILD-së, magjistratit gjatë hetimit, si dhe ndihmën përbëjnë mospërmbyllje të detyrës së në mënyrë aktive për të zhdukur ose zv.kryetarit, i cili ka përgjegjësi për mbapërkushtimin dhe funksionimin e gjykatës si konkluzionin se veprimet/mosveprimet e institucion, dhe ka krijuar konfuzion mbi ndërmarrja nga ana e zvkryetarit të ushtrimin e kompetencave të kancelares, Gjykatës Administrative të Shkallës së e cila është përgjegjës për menaxhimin e Parë Vlorë, B.SH., përbëjnë shkelje disiplinadministrimit gjyqësor. Nga ana tjetër, nore të parashikuar nga nenin 102 pika 1 moszbatimi pa shkaqe të arsyeshme nga shkronjat “g” dhe “gj” të ligjit nr. 96/2016 ana e tij si drejtues i një vendimi të dhënë “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokuronga Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësohet si rëve në Republikën e Shqipërisë”, të një sjellje joprofesionale, e cila diskrediton ndryshuar, konkretisht, si “Shkelje disiplinpozitën e drejtuesit të një gjykate dhe figurën e gjyqtarit në veçanti.

Në përfundim të hetimit, ILD duke mbajtur në konsideratë mes të tjerash, natyrën e shkeljes disiplinore, ekzistencën e rrethanës lehtësuese, e lidhur me shkeljet për herë të parë, bashkëpunimin e

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozoi KLGJ-së caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”, ndaj gjyqtarit B.Sh., kërkesë që u pranua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozoi KLGJ-së caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”, ndaj gjyqtarit B.Sh., kërkesë që u pranua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.



ILD ADRESON SITUATËN ME NUMRIN NË RRYTJE TË ANKESAVE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani konstatuar në 4 mujin e parë të vitit mbledhi në një takim pune Grupin e in-

spektorëve dhe Njësinë e ndihmës-

inspektorëve për të diskutuar mbi rishikimin e proceseve të brendshme të punës dhe rritjen e efikasitetit për shqyrtimin e ankesave në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike u bë një paraqitje e të dhënave statistikore për ankesat e ardhura dhe të shqyrtuara ndër vite, shpërndarja aktuale e ankesave dhe procesi i trajtimit të tyre, me theksin tek rritja e ndjeshme e numrit të ankesave, e

Diskutimet u fokusuan tek analiza e të dhënave konkrete dhe e proceseve të brendshme të punës, si dhe mënyrat efektive për të evaduar një numër të lartë ankesash brenda këtij viti, kjo për t'i paraprirë situatave të ngarkesave dhe krijimit

të stokut të ankesave. Në kushtet kur ILD ka një numër të ulët inspektorësh, më pak se gjysma e numrit të miratuar sipas organikës, në këtë takim pune u vlerësua si e nevojshme marrja e masave të tjera për të maksimizuar përpjekjet për trajtimin e një numri më të lartë ankesash, në



mënyrë që të mos krijohet stok.

“Trajtimi i ankesave të trashëguara, ka qenë një proces që ka tejkaluar ngarkesën normale të punës së ILD-së, për burimet njerëzore në dispozicion, por në sajë të masave rregullatore, administrative dhe strukturore të ndërmarra, rezultatet kanë qenë të dukshme dhe të matshme. Tani duhet parandaluar krijimi i stokut institucional, në kushtet e rritjes së numrit të ankesave dhe të mosndryshimit të burimeve njerëzore, që mbeten të ulëta.” u shpreh z. Metani.

Diskutimet mbi metodologjinë e punës sol-
lën evidentimin e problematikave që hasen
në proceset e trajtimit të ankesave dhe u
trajtuuan opsione të mundshme, për rritjen

e efijencës së shqyrtimit të ankesave, si
dhe nevoja për të rishikuar akte/rregullore
të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



FOTO NGA TAKIMI I PUNËS



PRILLI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Prill 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **160 nga ta cilat të depozituara nga qytetarë dhe 2 nga institucione**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Prill 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
99 vendime nga 198 praktika të trajtuara: 71 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar; 28 vendime arkivimi pas Verifikimit	12 vendime verifikimi	1 vendim fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrate (gjyqtar) ; 1 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 1 magjistrat (gjyqtar); 4 kërkesa për procedim disiplinor për 4 magjistratë)3 prokurorë e 1 gjyqtar)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Prill** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, **për 6 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Prill 2025,
Sektori i Ankesave dhe
Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ ka pritur 26 ankues,
të cilët janë paraqitur në ambi-
entet e Zyrës së Inspektorit të
Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ ka realizuar 30 telefonata me
qytetarë, të cilët kanë
kërkuar informacion mbi
fazën e ankesave të tyre ose
Informacion mbi plotësimin e
formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Prill 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **28 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Apr 11

Shumë i motivuar nga vizita e punës në institucione britanike të drejtësisë, që merren me kontrollin e magjistratëve. Eksperienca të ngjashme, këndvështrime të njëjta për vlerat e drejtësisë e shtetit të së drejtës. #ILD



From ild.al

1 4 51

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Apr 10

Me Ambasadorin tonë Uran Ferizi, një diplomat tejet aktiv në promovimin institucional të Shqipërisë në Faleminderit Ambasador për mbështetjen në organizimin e vizitës së #ILD në institucionet e 🇬🇧 në Londër. @UranFerizi @AlbanianDiplo




1 4 8 319

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Apr 7

📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD 🇬🇧

- ✅ 7230 të konfirmuara
- ✅ 5830 Ankesa të trajtuara
- ✅ 1400 Ankesa në proces trajtimi
- ✅ 168 Ankesa në proces verifikimi
- 👉 Më shumë ild.al
- 👉 Si të ankohe në #ILD ?

ild.al/sq/si-pranohen...




1 50

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Apr 7

📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD 🇬🇧

- ✅ 7230 të konfirmuara
- ✅ 5830 Ankesa të trajtuara
- ✅ 1400 Ankesa në proces trajtimi
- ✅ 168 Ankesa në proces verifikimi
- 👉 Më shumë ild.al
- 👉 Si të ankohe në #ILD ?

ild.al/sq/si-pranohen...



1 50

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania ·

📍 Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇬🇧

- ✅ 7230 të konfirmuara
- ✅ 5830 Ankesa të trajtuara
- ✅ 1400 Ankesa në proces trajtimi
- ✅ 168 Ankesa në proces verifikimi
- 👉 Më shumë ild.al
- 👉 Si të ankohe në #ILD ?

ild.al/sq/si-pranohen...




1 2 119

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania ·

📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD 🇬🇧

- ✅ 7230 të konfirmuara
- ✅ 5830 Ankesa të trajtuara
- ✅ 1400 Ankesa në proces trajtimi
- ✅ 168 Ankesa në proces verifikimi
- 👉 Më shumë ild.al
- 👉 Si të ankohe në #ILD ?

ild.al/sq/si-pranohen...



1 29

Prill 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara


© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD

Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!